

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ADEL SECURITY PRINT” SHPK



Në Tiranë, sot më datë **27.03.2019**, u mbledhen personalisht:

- 1- **Z. Arjan Lleshi**, Shtetas Shqiptar, i biri i **Hasanit**, lindur me **11.03.1965** ne **Tirane**, banues ne **Tirane** – identifikuar nga **leternjoftimi ID** me nr. **G50311091F**.

i cili themeloi shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “ADEL SECURITY PRINT” shpk dhe hartoi per kete qellim Aktin e Themelimit te shoqerise me permbajtje si vijon:

NENI 1

Themelimi

Themeluesi deklaroi themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “ADEL SECURITY PRINT” SHPK bazuar ne ligjin 9901 date 14.04.2008 “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” si dhe ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 per “Qendren Kombetare te Rregjistrimit”.

NENI 2

Selia

Selia e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar, “ADEL SECURITY PRINT” SHPK eshte Rr. “Muhamet Gjollësha”, Zogu i Zi, Kodi Postar 1001, Tirane - Shqiperi.

NENI 3

Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar eshte person juridik ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe aktiviteti i saj rregullohet sipas dispozitave te statutit te kesaj shoqerie dhe duke u bazuar dhe ne kete akt themelimi si dy akte baze te kesaj shoqerie.

NENI 4

Kohezgjatja

Kjo shoqeri ushtron aktivitetin e saj per nje afat kohor per me shume se 20 (njetzet) vjet.

NENI 5

- 1- Administratori i shoqerise do te jete z. Arjan Lleshi, me gjeneralitete: Shtetas Shqiptar i biri i **Hasanit**, lindur me **11.03.1965** ne **Tirane**, banues ne **Tirane** – identifikuar nga **leternjoftim ID** me nr. G50311091F. Administratori perfaqson shoqerine ne lidhje me te tretet. Ai ka tagrin te kryeje te gjithë proceduren e regjistrimit te kesaj shoqerie prane QKB, si dhe prane organeve tatimore. Ai ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, me perjashtim te çeshtjeve per te cilat kerkohet vendim i Asamblese se Pergjithshme. Administratori ka te drejte qe kompetencat e tij t’ia delegeje personave te trete me Prokure te Posaçme ku do te percaktohen shprehimisht te drejtat e deleguara vetem me miratimin e Asamblese se Pergjithshme.

NENI 6

Kapitali Themeltar

Kapitali fillestar i kesaj shoqerie eshte **100.000** (Njeqind mije) Leke i ndare ne 1 pjese ne vlere nominale 100,000 (Njemije) leke secila, i ndare ndermjet ortakeve si me poshte:

- **Arjan Lleshi** zoteron 1 (nje) kuote, me vlere 100.000 (Njeqind mije) Leke ne total.

Zmadhimi ose zvogelimi i ketij kapitali vendoset me vendim te Asamblese se Pergjithshme e cila mund te realizohet me ane te kontributeve ne para, ose me ane te kontributeve ne natyre, ose me perfshirje e rezervave dhe fitimit.

NENI 7

OBJEKTI

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Aktivitet ne fushen e shtypit dhe botimeve. Import-eksport. Shtepi botuese. Shtypshkronje per leter, karton, plastik, te gjitha llojet e shypit.
- Shtypshkronje e karakterit sekret.
- Publicitet, reklama. Organizim seminaresh, trajnimesh, panairesh, spektaklesh, perkthime ne gjuhe te nryshme.
- Agjensi udhetimesh. Agjensi komisionare dhe imobiliare.
- Prodhim e tregtim letre, kartoni, kancelari.
- Import- eksport dhe tregti me shumnice dhe e pakice te materialeve te ndertimit. Servis pajisjesh elektronike, automejte.
- Shperndarje te mjeteve publicitare. Sherbime postare, financiare dhe bankare, aktiviteti i gjithe sherbimeve baze te telekomunikacioneve dhe elektronike, veprimtari biznesi ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- Printim i faturave ne menyre dixhitale , selfmail dhe zarfim faturash . Prodhim dhe tregtim te kartave plastike me elemente sigurie, kartave biometrike, zgarave, pusetave metalike. Shiritave plastike, shiritave plastike per thase postare dhe vulave datare. Prodhim dhe tregtim targa prokat dhe shirita, prokat leje drejtimi, karta plastike, karta me elemente sigurie.
- Printim materiale filatelike.

NENI 8


Fillimin e aktivitetit te saj tregtar kjo shoqeri e lidh me regjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit si dhe me pajisjen me leje dhe licensa te nevojshme per zhvillimin e aktivitetit.

NENI 9

Aktiviteti ekonomik dhe investimet e kesaj shoqerie mbrohen nga legjislacioni shqiptar ne fuqi. Ky akt u redaktua ne 4 kopje ne prani te aksionerit dhe pasi miratohet nen per nen dhe ne parim nga themeluesit Shoqerise Me Pergjegjesi Te Kufizuar **Arjan Lleshi** nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emër, mbiemër dhe firmën origjinale.

THEMELUESI

Arjan Lleshi



VERTETIM

Sot me datë 27.03.2019, para meje noteres Ardjana A. MEDIU, me seli në adresën: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 7, Tiranë, u paraqit personalisht:

Z.Arjan Lleshi, i biri i Hasan-it, i datëlindjes 11.03.1965, lindur dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar prej meje me Letërnjoftim me Nr.Personal G50311091F., *ne cilesine e themeluesit te Shoqerise "ADEL SECURITY PRINT" Sh.p.k.*

I cili deklaroi se:

Dokumentin e bashkangjitur këtij akti, **Akt Themelimi i Shoqerise "ADEL SECURITY PRINT" Sh.p.k, date 27.03.2019** e ka hartuar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë jashtë kësaj zyre noteriale dhe e nënshkroi atë në praninë time. Unë noterja e vërtetoj nënshkrimin në bazë të ligjit.

NOTERE

Ardjana A. MEDIU

